



NEWSLETTER

Shkurt 2024

Nr.2

Është mbajtur takim dypalësh ndërmjet ASHMA-së dhe KPM



Përfaqësuesit e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe Komisionit të Pavarur për Media të Republikës së Kosovës (KPM) më 20 shkurt në ambientet e ASHMA-së kanë mbajtur një takim dypalësh.

Në takim u diskutua për disa çështje, me theks në përvojat praktike dhe aktivitetet që lidhen me harmonizimin e rregullativës vendase të medias me atë evropiane dhe zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Direktiva e rishikuar e Shërbimeve Mediatike Audiovizuale. Vëmendje e veçantë iu kushtua përvojave në lidhje me mënyrën e realizimit të monitorimit të përmbajtjeve mediatike gjatë proceseve zgjedhore.

Në fund të takimit, përfaqësuesit e dy trupave rregullator konstatuan se bashkëpunimi i ndërsjellë duhet të vazhdojë edhe më tej në drejtim të shkëmbimit të informacioneve në fushën e rregullatorit mediatik për çështje që janë me interes të përbashkët për të dyja palët.

Transmetuesit të respektojnë Kodin Zgjedhor

Më 15 shkurt, Agjencia njofton transmetuesit se me shpalljen e Zgjedhjeve Presidenciale dhe Parlamentare, të planifikuara për më 24 prill, gjegjësisht 8 maj 2024, hynë në fuqi dispozitat e Kodit Zgjedhor. Me këtë fillon monitorimi i raportimit mediatik nga ASHMA-ja, i cili deri në fillim të fushatës zgjedhore do të jetë i fokusuar në nëntë shërbime programore televizive në nivel shtetëror, ndërsa të gjitha shërbimet e tjera programore do të monitorohen në bazë të parashtesës.

Radiodifuzerët që do të transmetojnë reklamim të paguar politik (RPP) duhet të respektojnë afatin prej 3 ditësh për regjistrim në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve, gjegjësisht prej 5 ditësh për përcaktimin e listave të çmimeve për RPP dhe dorëzimin e tyre tek institucionet kompetente – KSHZ, ESHR, KSHPK dhe ASHMA. Raportimi për aktivitetet e rregullta të organeve shtetërore, organeve komunale dhe qytetit të Shkupit, institucioneve dhe organizatave shtetërore, si dhe për subjekte të tjera juridike me kompetenca publike, nuk guxon të jetë në funksion të përfaqësimit mediatik zgjedhor të asnjë subjekti politik. Duhet të respektohen rregullat për publikimin e rezultateve të sondazheve të opinionit publik lidhur me pjesëmarrësit në procesin zgjedhor, si dhe ndalesat për transmetimin e RPP para fillimit të fushatës zgjedhore, për transmetimin e reklamave të financuara nga buxheti dhe ndalimin e njëkohshëm për angazhim të redaktorëve, gazetarëve, drejtuesve të programeve dhe prezantuesve në programet e transmetuesve dhe në aktivitetet parazgjedhore të pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore.

Shërbimi publik radiodifuziv dhe transmetuesit kombëtar që kanë vendosur të mbulojnë procesin zgjedhor, janë të detyruar këtë ta bëjnë në format dhe në gjuhë të aksesueshme dhe të qasshme për personat me aftësi të kufizuara. Transmetuesit gjatë raportimit për procesin zgjedhor janë të detyruar të respektojnë parimet profesionale të veprimtarisë gazetareske, veçanërisht parimin e paraqitjes objektive, të paanshme të ngjarjeve, me trajtim të barabartë të pikëpamjeve dhe opinioneve të ndryshme, në mënyrë që t'i mundësojnë audiencës lirisht të formojnë mendimin e tyre për ngjarje dhe çështje të veçanta. Në të njëjtën kohë, të gjithë transmetuesit janë të obliguar të respektojnë ndalesat e veçanta nga neni 48 i LSHMAAV.

Si edhe më parë, Agjencia, në ueb faqen e saj ka vendosur baner në gjuhën maqedonase, shqipe dhe angleze me të gjitha materialet lidhur me procesin zgjedhor – aktet ligjore dhe nënligjore, formularin për parashtesa etj.

Dënim për deklaratën e kryetarit të partisë politike të LSDM-së

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale më 21 shkurt, përmes një njoftimi për media, dënoi ashpër deklaratën e kryetarit të partisë politike LSDM-së, Dimitar Kovačevski, me të cilën ai akuzoi mediat “se vetë u shitën dhe akoma po shiten” dhe vihen në funksion të një partie politike.

Në njoftim thuhet se politikanët duhet të jenë të vetëdijshëm për përgjegjësinë që kanë dhe në vend që të përdorin komunikim të papërshtatshëm, të tregojnë nivel më të lartë të respektit për profesionin e gazetarit dhe të një nga shtyllat kyçe të demokracisë – mediat. Etiketimi i medias, veçanërisht në periudha të ndjeshme si ato parazgjedhore, ndikon negativisht në lirinë e shprehjes dhe çënon dinjitetin e punonjësve të medias. Agjencia kujtoi se është e nevojshme të respektohen standardet dhe u bëri thirrje politikanëve që të përmbahen nga përdorimi i gjuhës që diskrediton median.



NEWSLETTER

Qytetarët mund të reagojnë ndaj sjelljeve në hapësirën online gjatë zgjedhjeve

Me shpalljen e Zgjedhjeve Parlamentare dhe Presidenciale, filloi dhe periudha e veprimit të Trupit Koordinues për monitorimin e respektimit të Kodit të Sjelljes në hapësirën online gjatë proceseve zgjedhore dhe referendumeve. Trupi koordinues do të veprojë sipas parashtesave (ankesave) në lidhje me shkeljet e mundshme të Kodit nga partitë politike, kandidatët e tyre, kandidatët e pavarur, edicionet në internet të transmetuesve, mediat online, kontrolluesit e fakteve, ndikuesit dhe subjektet e tjera që mund të kenë ndikim mbi publikun në funksion të fushatës gjatë zgjedhjeve ose referendumet.

Të gjithë qytetarët dhe personat juridikë mund të dërgojnë parashtesat (peticione) në adresën e-mail adresë: koordinativnotelozaizbori@avmu.mk. Trupi koordinues përbëhet nga përfaqësues të: Asociacionit të Gazetarëve të Maqedonisë, Institutit Maqedonas për Media, Këshillit për Etikë në Media në Maqedoni, Institutit për Studime të Komunikimit, Fondacionit "Metamorfozis" dhe Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Për koordinator të trupit u zgjodh Sashe Dimovski nga Asociacioni i Gazetarëve të Maqedonisë, ndërsa zëvendës koordinatore Olivera Vojnovska nga Fondacioni Metamorfozis.

Mbikëqyrja e transmetuesve, operatorëve të rrjeteve publike të komunikimit elektronik dhe medias së shkruar

Transmetuesit

Mbikëqyrje e rregullt programore dhe administrative për respektimin e rregullave gjatë transmetimit të komunikimeve komerciale audiovizuale, mbrojtja e të miturve (fëmijëve), ofrimi i kuizeve ose formave të tjera të pjesëmarrjes në çmime, përdorimi i shërbimeve telefonike me vlerë të shtuar dhe votimi telefonik, transmetimi i lojërave të fatit, përdorimi i gjuhës në programe, transmetimi ditor së paku 12 orë program në televizion dhe së paku 18 orë program në radio, transmetim ditor i një përqindje të caktuar të programeve të krijuar burimor si vepra audio ose audiovizuale maqedonase, publikim impresium, informacion i disponueshëm për përdoruesit dhe identifikimi i transmetuesit është kryer mbi TV dhe radio kanalet e Shërbimit Publik - TVMT 1, TVMT 2, TVMT 3, TVM 4, TVM 5 dhe RTM 1, RTM 2, RTM 3. Gjatë mbikëqyrjes është konstatuar se TVM 2, më 2 shkurt, në programin e saj nuk ka transmetuar së paku 40% program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase.

Ndaj TV Kompani 21-M, Radio PRO-FM dhe Radio Metropolis, është kryer mbikëqyrje e jashtëzakonshme administrative për të përcaktuar nëse e përmbushin detyrimin për sigurimin e kushteve kadrovike në pajtim me LSHMAAV dhe Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësimore, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për transmetim në radio dhe televizion. Nga mbikëqyrja u konstatua se është përmbushur detyrimi ligjor nga të dy transmetuesit.

Është kryer mbikëqyrje e kontrollit programor dhe administrativ ndaj TV Telma, Radio Metropolis dhe Radio Balkan FM për të përcaktuar nëse kanë vepruar sipas masave të shqiptuara më parë vërejtje publike. Mbikëqyrja rezultoi se transmetuesit në tërësi (plotësisht) kanë vepruar sipas masave të shqiptuara më parë.

Operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik

Agjencia ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore mbi operatorët Viva Net, Altra-Sat 2000, Infel-KTV, Telekabel, Pet Net, Altra Sat, Infel KTV, Multimedia Network, Pet Net, Telekabel, Telenet, Telenet Kom, Skrembl, Multimedia Network L, Kombo 2003 dhe IP Sistem për detyrimin në paketën programore që e ritransmeton detyrimisht dhe pa pagesë për të ofruar shërbimet programore të shërbimit publik radiodifuziv, si dhe për detyrimet për regjistrimin e shërbimeve programore në Agjenci dhe titrimin e programeve që ritransmeton. Mbikëqyrja rezultoi se operatorët Multimedia Network, Infel KTV dhe Telenet ritransmetojnë shërbime programore që nuk mbulohen me certifikatë për regjistrimin e shërbimeve programore të lëshuara nga Agjencia.



NEWSLETTER

Media e shkruar

Është kryer mbikëqyrja e rregullt administrative ndaj 19 botues të medias së shkruar me qëllim për të përcaktuar nëse kanë publikuar të dhëna për emrin dhe adresën e selisë qendrore dhe redaksisë së medias së shkruar, të dhëna për personin përgjegjës, redaktorët, shtypshkronjën, datën e shtypjes. ose ribotim dhe numri i kopjeve të shtypura, në pajtim me detyrimin e Ligjit për Media. Mbikëqyrja rezultoi se mediat e shkruara i kanë përmbushur detyrimet ligjore.

Mbikëqyrja e kontrollit administrativ është kryer ndaj KOLOR MEDIA PLUS, botues i medias së shkruar "The Economist", për të përcaktuar nëse është vepruar sipas Aktvendimit për ndërmarrje të masës vërejtje publike, drejtuar për mospublikimin e adresës së selisë së botuesit të medias, adresën e shtypshkronjës, datën e shtypjes ose ribotimit dhe numrin e kopjeve të shtypura. Nga mbikëqyrja u konstatua se media e shkruar pjesërisht ka vepruar sipas Aktvendimit për marrjen e masës, përkatësisht nga të dhënat për mospublikimin e të cilave ishte paralajmëruar më parë, në botimin me nr.6 të dhjetorit 2023, nuk ka publikuar të dhënat për adresën e selisë së botuesit të medias (e cila nuk është publikuar as në botimin nr. 5), dhe për më tepër nuk ka publikuar dhe të dhënat për adresën e redaksisë së botuesit të medias.

Masat e shqiptuara vërejtje publike

Në bazë të konstatimeve nga mbikëqyrjet e rregullta programore, Këshilli i Agjencisë në seancën e 6-të, mbajtur më 19 shkurt, ka miratuar tri Aktvendime për shqiptimin e masës vërejtje publike për operatorët Multimedia Network L nga Gostivari, Telenet Kom nga Tetova dhe Infel-KTV nga Ohri.

Masat janë shqiptuar për shkak të ritransmetimit të shërbimeve programore që nuk mbulohej me çertifikatë për regjistrimin e shërbimeve programore të lëshuar nga Agjencia.